


BIK-u dhe Ipeshkvia
e Kosovës mbështesin
marshin "Drejtësi,
jo politikë" më 17 shkurt



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA E HASHIM THAÇIT PARAQET DEKLARATËN PËRMBYLLËSE
NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

MBROJTJA ÇMONTON PRETENDIMET E ZPS-së PËR THAÇIN

FAQE 4-5

- Avokati Misetiq, ZPS-së dhe trupit gjykues:
Thaçi është i pafajshëm.
Dënimi do të ishte padrejtësi historike.
S'mund ta rishkruani historinë e Kosovës

Avokatët e ish-presidentit Hashim Thaçi kanë paraqitur para trupit gjykues deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Avokati Luka Misetiq ka thënë se Thaçi është plotësisht i pafajshëm dhe se pretendimet e ZPS-së nuk kanë asnjë bazë faktike. Ai ka kërkuar lirimin e Thaçit dhe kthimin e tij në Kosovë. Duke ofruar kundërgargumente ndaj pretendimeve të ZPS-së, Misetiq ka thënë se dënimi i Thaçit do të ishte padrejtësi historike. Në këtë kontekst, ai ia ka bërë me dije trupit gjykues dhe ZPS-së se nuk mund ta rishkruajnë historinë e Kosovës. Misetiq dhe avokatët e tjerë e kanë kritikuar ashpër ZPS-në në lidhje me dëshmitarët e mbrojtjes, duke i bërë thirrje trupit gjykues që dëshmitë të tyre të trajtohen seriozisht



KOSOVA BËHET ME INSTITUCIONE TË REJA, ME KUVEND DHE QEVERI

F. 8

RUBIO NË KONFERENCËN E
MUNIHT, ATY PRITET TË MARRË
PJESË EDHE KOSOVA F. 2

AKADEMIK ARSIM BAJRAMI
EMËROHET PËRGJEGJËS PËR
BASHKËPUNIMIN ME INSTITUTIN
PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË
LUFTËS F. 3

KOSOVË - SHQIPËRI, FORCIMI I
PARTNERITETIT DOGANOR PËR
LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE
ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 8

SPORT



KOSOVA, GATI PËR SHORTIN E LIGËS
SË KOMBEVE F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBIO NË KONFERENCËN E MUNIHUT, ATY PRITET TË MARRË PJESË EDHE KOSOVA

UASHINGTON, 11 SHKURT - Kryediplomati amerikan Marco Rubio do të udhëtojë për në Gjermani gjatë javës dhe do të udhëheqë një delegacion të nivelit të lartë në Konferencën për Siguri të Munihut para se të nisët drejt Sllovakisë dhe Hungarisë.

Konferenca e 62-të e Munihut do të mbahet nga 13 deri më 15 shkurt, ku pritet të marrin pjesë qindra udhëheqës botërorë, përfshirë edhe nga Kosova. Në Munih pritet të jetë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, dhe shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Petrit Ajeti.

Edhe Serbia pritet të ketë përfaqësues në Konferencë, përfshirë presidentin Aleksandar Vuçiq, kryediplomatin Marko Gjuriq, dhe disa ministra të tjerë. Edhe vendet e tjera të rajonit pritet të përfaqësohen në Munih me zyrtarë të lartë, përfshirë kryeministria.

Pjesëmarrja e Rubios në këtë konferencë ndodh në një moment të rëndësishëm, kur Uashingtoni dhe aleatët evropianë po përballen me mosbesim në rritje lidhur me

sigurinë, tregtinë dhe të ardhmen e aleancës transatlantike dhe këto tensione pritet të mbizotërojnë diskutimet në Munih.

Lufta e Rusisë në Ukrainë, që në fund të shkurtit hyn në vitin e pestë, pritet të jetë temë kryesore e diskutimeve në Konferencë, por edhe tensionet që kanë të bëjnë me Iranin.

Pjesëmarrja e Rubios në Konferencën në Gjermani do të pasohet me një turne diplomatik në Bratisllavë dhe Budapest më 15 dhe 16 shkurt, duke vënë në pah fokusin e administratës amerikane në Evropën Qendrore në një kohë të një pasigurie strategjike.

Në Sllovaki ai pritet të takohet me zyrtarë të lartë për ta avancuar bashkëpunimin e sigurisë rajonale dhe për projektet e energjisë bërthamore, tha Departamenti Amerikan i Shtetit. Në Hungari, ndërkaq, fokusi do të jetë në raportet dypalëshe dhe në përpjekjet e paqes që synojnë zgjidhjen e konflikteve botërore. Pika kryesore e udhëtimit të Rubios do të jetë fjalimi në Munih më 14 shkurt, i cili pritet të shikohet me vëmendje, veçmas pasi fjalimi i



nënpresidentit amerikan, JD Vance, vitin e kaluar në këtë konferencë, pati jehonë të madhe.

Atëbotë deklaratat e Vance - kur ai akuzoi liderët evropianë për shtypje të lirisë së shprehjes dhe dështim në menaxhimin e migracionit - lanë pas një ndjenjë shqetësimi në Bruksel dhe më gjerë.

Kjo ndjesi pasigurie pasqyrohet edhe në raportin vjetor të Konferencës së Sigurisë së Munihut, të hartuar nga organizatorët e forumit dhe të publikuar këtë javë, i cili paralajmëron se Evropa po përballët me një “epokë të prolonguar konfrontimi” të

nxitur nga agresioni rus.

Tensionet transatlantike

Sipas raportit, sfida më e madhe për rendin liberal ndërkombëtar mund të vijë tashmë “nga brenda”, duke iu referuar asaj që e përshkruan si një ndryshim tektonik në mënyrën se si ShBA-ja po mendon për aleancat.

Duke e quajtur presidentin amerikan, Donald Trump, “më të fuqishmin ndër ata që i bien me sëpatë rregullave dhe institucioneve ekzistuese”, autorët e raportit parashikojnë se “marrëveshjet transaksionale mund ta zëvendësojnë bashkëpunimin e ndërtuar mbi

parime... dhe rajonet mund të dominohen nga fuqitë e mëdha, në vend që të qeverisen nga rregulla dhe norma ndërkombëtare”.

Ambasadori amerikan në NATO, Matthew Whitaker, e ka kundërshtuar fuqishëm vlerësimin për një “kërcënim të brendshëm”, duke argumentuar se Uashingtoni synon të ribalancojë, e jo të shkatërrojë, rendin e pasluftës.

Duke folur për gazetarët më 9 shkurt, Whitaker kundërshtoi idenë se ShBA-ja po largohet nga aleancat e qëndrueshme. “Ne po përpiqemi ta bëjmë NATO-n më të fortë”, deklaroi ai, duke argumentuar se presioni ndaj aleatëve evropianë për të shpenzuar më shumë për mbrojtjen lidhet me rritjen e kapaciteteve, jo me braktisjen e aleancës.

Sa i përket tregtisë, ai e paraqiti qëndrimin e ShBA-së si një përgjigje ndaj asaj që e quajti pabarazi të padrejta.

Sa i përket Grenlandës, për të cilën Trumpi ka thënë se dëshiron që ShBA-ja ta marrë nën kontroll, Whitaker tha se ky synim ka të bëjë me shqetësimet të sigurisë që lidhen me Rusinë dhe Kinën.

PROTESTA E OPOZITËS NË TIRANË BËN JEHONË NË MEDIET GJERMANE

TIRANË, 11 SHKURT - Shkallëzimi i protestës së opozitës në Tiranë me disa të lënduar një ditë më parë, të martën, ka gjetur jehonë në mediet gjermane. Qytetarët janë të zemëruar me qeverinë Rama, shkruajnë ato.

Portali “tagesschau” i ARD me titullin “Trazira gjatë protestave në Tiranë” shkruan se në protestën e opozitës në Tiranë ka pasur përplasje të rënda mes policisë dhe kundërshtarëve të qeverisë. “Mijëra njerëz u mbledhën në sheshin kryesor të martën në mbrëmje për të kërkuar dorëheqjen e zëvendëskryeministres Belinda Balluku, e cila akuzohet për korrupsion. Disa demonstrues hodhën Molotovë drejt një ndërtese qeveritare, dhe policia përdori ujë me presion. [...] Tensionet politike u përshkallëzuan në dhjetor pasi një zyrë e prokurorit të posaçëm ngriti akuza kundër Ballukut. Ajo akuzohet për ndërhyrje në tenderët publikë për projekte të mëdha infrastrukturore dhe favorizim të kompanive të caktuara. Balluku, e cila është gjithashtu ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, i mohon



akuzat”.

Gazeta gjermane “Die Zeit” i kushton vëmendje protestës në Shqipëri duke theksuar shkallëzimin e saj. “Përleshje shpërthyen midis policisë dhe demonstruesve gjatë një proteste kundër qeverisë shqiptare në kryeqytetin e vendit, Tiranë. Sipas policisë, të paktën 16 oficerë u plagosën dhe 13 persona u arrestuan. [...] Mijëra mbështetës të opozitës kërkuar dorëheqjen e qeverisë së kryeministrit Edi Rama në një demonstratë. Qeveria është kritikuar ashpër për shkak të akuzave për korrupsion që

përfshijnë zëvendëskryeministren Belinda Balluku. Anëtarëve të parlamentit iu bë thirrje të heqin imunitetin e saj parlamentar në mënyrë që ajo të mund të ndiqet penalisht. Rama kishte refuzuar ta shkarkonte Ballukun”.

Ndërsa portali NTV shkruan se qytetarët janë të zemëruar në kohën kur, prokuroria heton në një rast të dyshuar korrupsioni kundër zëvendëskryeministres, Balluku. Sërish shpërthyen protesta në Tiranë. “Përleshje të dhunshme shpërthyen midis policisë dhe protestuesve antiqeveritarë në kryeqytetin e

Shqipërisë, Tiranë. Mijëra njerëz u mbledhën në sheshin kryesor të martën në mbrëmje, duke kërkuar dorëheqjen e zëvendëskryeministres Belinda Balluku, e cila përballët me akuza për korrupsion. Demonstruesit, shumë prej të cilëve ishin të maskuar, hodhën kokteje Molotov në një ndërtesë qeveritare, duke bërë që policia të përdorte ujin me presion. [...] Këto trazira janë të fundit në një seri protestash të dhunshme që kanë kërcënuar gjithnjë e më shumë sundimin e Kryeministrit Edi Rama, i cili filloi në vitin 2013”.

“Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, shpërthyen përleshje të dhunshme midis policisë dhe kundërshtarëve të qeverisë. Mijëra njerëz u mbledhën në sheshin kryesor të martën në mbrëmje për të kërkuar dorëheqjen e zëvendëskryeministres Belinda Balluku, e cila akuzohet për korrupsion. Demonstruesit hodhën kokteje Molotov në një ndërtesë qeveritare dhe policia përdori ujin me presion. Trazirat janë të fundit në një seri protestash të ashpra që po

kërcënojnë gjithnjë e më shumë qeverisjen e kryeministrit Edi Rama, që zgjat që nga viti 2013”, shkruan RTR për Gjermaninë.

Radioja gjermane “Deutschland Funk” shkruan se në kryeqytetin shqiptar ka pasur përplasje me policinë në një demonstratë të opozitës në Tiranë. “Pas fjalimit të politikanit të opozitës së djathtë, Berishës, përpara selisë së qeverisë, demonstruesit hodhën molotovë dhe gurë drejt policisë. Më vonë, pjesëmarrësit u përpoqën të thyenin barrikatat e policisë gjatë rrugës për në parlament. Policia u përgjigj me ujë me presion dhe gaz lotsjellës.[...] Të dy kampet politike akuzojnë njëri-tjetrin për korrupsion. Berisha akuzohet për dhënie kontratash publike bashkëpunëtorëve, gjë që ai e hedh poshtë. Të mërkurën, një komision parlamentar është planifikuar të diskutojë kërkesën nga zyra e prokurorit publik për heqjen e imunitetit të zëvendëskryeministres Balluku. Kërkesa ka të bëjë me akuzat për përfshirjen e saj në një rast korrupsioni që lidhet me kontratat publike”.

KOSOVA BËHET ME INSTITUCIONE TË REJA, ME KUVEND DHE QEVERI

Albulena Haxhiu është zgjedhur të mërkurën kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa Albin Kurti kryeministër. Qeveria Kurti 3 u votua nga 66 deputetë, po aq vota mori edhe Haxhiu për postin e kryetares së Kuvendit. Institucionet e reja u formuan pas pothuajse një viti me Qeveri në detyrë dhe me një Kuvend pothuajse tërësisht jofunksional.

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Të mërkurën, më 11 shkurt, u konstituua Kuvendi i ri i Kosovës me kryeparlamentare Albulena Haxhiun dhe u votua Qeveria e re, me Albin Kurtin në krye. Haxhiu dhe Kurti në pozitat që përfaqësojnë u zgjedhën me 66 vota të deputetëve. Institucionet e reja u formuan pas pothuajse një viti me Qeveri në detyrë dhe Kuvend gati tërësisht jofunksional. Kjo, pasi Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit, pas zgjedhjeve të shkurtit 2025, nuk pati vota të mjaftueshme për të krijuar Qeverinë, por këtë e arriti pas zgjedhjeve të dhjetorit të po atij viti, në të cilat



fitoi 57 mandate. Nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës u zgjedhën Ardian Gola,

Vlora Çitaku, Kujtim Shala, Sllavko Simiq dhe Emillija Rexhepi.

QEVERIA KURTI 3

Kryeministër **Albin Kurti**
Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, **Glauk Konjufca**
Zëvendëskryeministër e dytë dhe ministre e Drejtësisë, **Donika Gërvalla**
Zëvendëskryeministër i tretë për çështje të pakicave dhe bashkëpunim, **Fikrim Damka**
Ministër i Financave, **Hekuran Murati**
Ministër për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, **Andin Hoti**
Ministër i Mbrojtjes, **Ejup Maqedonci**
Ministër i Punëve të Brendshme, **Xhelal Sveçla**
Ministër i Digjitalizimit dhe Administratës Publike, Lulëzon Jagxhiu
Ministër i Shëndetësisë, **Arben Vitia**
Ministër i Arsimit dhe Shkencës, **Hajrulla Çeku**
Ministre e Kulturës dhe Turizmit, **Saranda Bogujevci**
Ministër i Sportit dhe Rinisë, **Blerim Gashani**
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, **Elbert Krasniqi**
Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **Fitore Pacolli**
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Armend Muja**
Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, **Dimal Basha**
Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, **Mimoza Kusari**
Ministre e Ekonomisë, **Artane Rizvanolli**
Ministër për Komunitete dhe Kthim, **Nenad Rashiq**
Ministër për Zhvillim Rajonal, **Rasim Demiri**

SHEFAT E SHTABEVE TË KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE KROACISË THELLOJNË BASHKËPUNIMIN USHTARAK



PRISHTINË, 11 SHKURT - Komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, ka marrë pjesë në takimin trilateral me Shefat e Shtabeve të Shqipërisë dhe Kroacisë. Takimi trilateral i cili u mbajt në Republikën e Shqipërisë në mes të shefave të mbrojtjes së Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë shënoi një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe koordinimit strategjik në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Gjeneral Jashari, gjeneral Kingji dhe gjeneral Kundid zhvilluan një diskutim të hapur dhe konstruktiv mbi sfidat aktuale të sigurisë, thellimin e

bashkëpunimit ushtarak, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe avancimin e kapaciteteve mbrojtëse në përputhje me standardet euroatlantike. Takimi konfirmoi përkushtimin e përbashkët për paqe, stabilitet dhe siguri të qëndrueshme në rajon. Po ashtu ky takim potencoi gatishmërinë për të zgjeruar bashkëpunimin përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta, shkëmbimit të përvojave dhe koordinimit strategjik. Kjo iniciativë trilaterale përfaqëson një shembull të partneritetit të fortë dhe vizionit të përbashkët për një rajon më të sigurt dhe më të qëndrueshëm.

AKADEMIK ARSIM BAJRAMI EMËROHET PËRGJEGJËS PËR BASHKËPUNIMIN ME INSTITUTIN PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK), Justina Pula, dhe akademiku Arsim Bajrami kanë pritur në takim drejtorin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, At dhe Hetemi, me bashkëpunëtorë. Gjatë takimit u diskutuan mundësitë konkrete të bashkëpunimit institucional ndërmjet AShAK dhe Institutit, përfshirë nënshkrimin e një memorandumit të mirëkuptimit, shkëmbimin dhe shfrytëzimin e literaturës, arkivave dhe

bibliografisë shkencore, organizimin e konferencave, tryezave dhe simpoziumeve të përbashkëta, si dhe angazhimin e ekspertizës akademike dhe multidisiplinare në funksion të dokumentimit dhe analizimit shkencor të krimeve të luftës në Kosovë. Në këtë kuadër, u theksua edhe kontributi i rëndësishëm i AShAK gjatë katër viteve të fundit, përmes organizimit të konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe botimit të studimeve, përmbledhjeve dhe monografive shkencore, ku krimet

e luftës dhe gjenocidi i kryer nga Serbia në Kosovë janë trajtuar me argumente shkencore, qasje metodologjike të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe historisë bashkëkohore, duke kontribuar në ruajtjen e kujtesës historike dhe në kundërshtimin e tendencave për relativizim dhe rishkrim të historisë. Me vendim të Kryesisë së AShAK-ut, akademik Arsim Bajrami është caktuar përgjegjës për bashkëpunimin institucional me Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës.



Delegacioni i Emirateve viziton Kosovën, ofron mbështetje për sektorin e shëndetësisë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Pas takimit të shkëlqyeshëm me presidentin e Emirateve, Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan, javën e kaluar në Abu Dhabi, presidentja Vjosa Osmani ka pritur në Kosovë delegacionin e lartë të dërguar personalisht prej tij - me një mision të qartë: mbështetjen e

vazhdueshme për sektorin e shëndetësisë, si dhe thellimin e marrëdhënieve tona dypalëshe përmes projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. “Së bashku me delegacionin e Emirateve dhe Ministrin Vitia u mirëpritëm nga stafi e menaxhmenti i QKUK, prindër

e fëmijë në spitalin e fëmijëve Sheikh Fatima, të ndërtuar nga Emiratet, si dhe vizituam lokacionin ku do të ndërtohet spitali i ri i gjinekologjisë në Prishtinë, i cili bazuar në dakordimin tonë paraprak do të bëhet me mbështetje të Emirateve. Më pastaj vizituam Mitrovicën ku u pritëm nga

kryetari Faton Peci dhe diskutuam edhe idenë e një projekti të ri transformues në të mirë të të gjithë qytetarëve tanë. Mirënjohje e thellë për Lartësinë e tij, presidentin Mohamed bin Zayed Al Nahyan, si dhe për Lartësinë e saj, Sheikh Fatima Bint Mubarak, për mbështetjen, besimin dhe miqësinë e sinqertë



ndaj Kosovës”, ka theksuar Osmani.



MBROJTJA E HASHIM THAÇIT PARAQET DEKLARATËN PËRMBYLLËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

MBROJTJA ÇMONTON PRETENDIMET E ZPS-së PËR THAÇIN

- Avokati Misetiq, ZPS-së dhe trupit gjykues: Thaçi është i pafajshëm. Dënimi do të ishte padrejtësi historike. S'mund ta rishkruani historinë e Kosovës

Avokatët e ish-presidentit Hashim Thaçi kanë paraqitur para trupit gjykues deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Avokati Luka Misetiq ka thënë se Thaçi është plotësisht i pafajshëm dhe se pretendimet e ZPS-së nuk kanë asnjë bazë faktike. Ai ka kërkuar lirim të Thaçit dhe kthimin e tij në Kosovë. Duke ofruar kundërgjegjësi ndaj pretendimeve të ZPS-së, Misetiq ka thënë se dënimi i Thaçit do të ishte padrejtësi historike. Në këtë kontekst, ai ia ka bërë me dije trupit gjykues dhe ZPS-së se nuk mund ta rishkruajnë historinë e Kosovës. Misetiq dhe avokatët e tjerë e kanë kritikuar ashpër ZPS-në në lidhje me dëshmitarët e mbrojtjes, duke i bërë thirrje trupit gjykues që dëshmitë e tyre të trajtohen seriozisht

“Nuk ka prova se ka ekzistuar ‘ndërmarrja e përbashkët kriminale’”

Avokati i Hashim Thaçit, Luka Misetiq, gjatë paraqitjes së deklaratës përmbyllëse është fokusuar te pika e akuzës së ZPS-së se ka ekzistuar një Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale (NPK), në krye me të akuzuarit, me qëllim të marrjes nën kontroll të gjithë Kosovës. Misetiq u ka thënë gjyqtarëve se nuk ka pasur prova të drejtpërdrejta që ka ekzistuar një plan i tillë. “Nuk ka pasur prova të takimeve ku është diskutuar ky synim, dokumente shkresore që tregohet se është rënë dakord apo është diskutuar ky synim. Nuk ka dhënë dëshmi asnjë dëshmitar lidhur me ekzistencën e këtij synimi. Në fakt, secili prej dëshmitarëve që e ka pasur mundësinë të flasë për këtë çështje, e ka hedhur poshtë teorinë e ZPS-së dhe, për më keq, ZPS-ja nuk i ka bërë pyetje asnjë dëshmitari”, ka thënë Misetiq, duke vazhduar me kundërgjegjësi të cilat rrëzojnë pretendimet e prokurorisë. “Nga njëra anë prokuroria thotë se UÇK-ja ka pasur një sistem tërësisht funksionues të komandimit nga shtabi i përgjithshëm deri te zonat, mundësinë për të komunikuar mes shtabit të përgjithshëm dhe zonave, mundësinë për të lëshuar urdhra detyruese nga shtabi i përgjithshëm për anëtarët e zonave, si dhe mundësinë për të ushtruar disiplinë, për t'i dënuar nivelet më të ulëta në rast të moszbatimit të urdhrave”, ka thënë ai. Por, sipas Misetiqit, pavarësisht prej këtyre pretendimeve, vetë prokuroria më pas ka thënë se mënyra

themelore përmes së cilës kanë komunikuar anëtarët e “Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK)”, e kanë komunikuar politikën e tyre kundër kundërshtarëve, ka qenë përmes komunikatave, deklaratave politike dhe deklaratave të tjera, të cilat ushtarët i pranonin përmes medie publike. “Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk shpjegon se pse anëtarë të NPK-së nuk kanë lëshuar urdhra të cilët etiketonin të ashtuquajturit oponentë. Ne parashtrijmë se çështja e ZPS-së nuk është konsistente dhe, në fakt, nuk ka pasur as komandë dhe kontroll dhe as prova të besueshme që zonat i kanë interpretuar komunikatat si politikë për të kryer krime kundër personave të perceptuar që pengonin anëtarët e NPK-së që të kishin kontroll të plotë mbi Kosovën”, ka thënë ai. Avokati i Hashim Thaçit ka thënë se nuk është i vërtetë as pretendimi i prokurorisë se shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, në verën e vitit 1998, ka refuzuar në çdo mënyrë të mundshme, “me zjarr” qeverinë e zgjedhur të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe që ndërmorën hapa për të krijuar “një qeveri të re”. “Duhet të theksojmë që kjo është e pasaktë, faktikisht dhe juridikisht. Nuk ka ekzistuar një qeveri e zgjedhur e LDK-së, s'ka pasur zgjedhje dhe s'ka pasur qeveri të LDK-së. LDK-ja ka qenë parti politike, një grup joshetëror dhe të ashtuquajturat zgjedhjet që ka mbajtur, kanë qenë zgjedhje joshetërore. Madje Qeveria e (Bujar) Bukoshit, as nuk ka qenë në Kosovë, ka qenë një qeveri e ashtuquajtur në mërgim. LDK-ja nuk kishte më shumë legjitimitet sesa UÇK-ja për të pretenduar autoritetin që pretendonin”, ka

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 11 SHKURT - Mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi ka shkëlqyer të mërkurën gjatë paraqitjes së deklaratave përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Për disa orë avokatët e Thaçit kanë argumentuar pafajësinë e ish-presidentit dhe përfaqësuesit politik të UÇK-së, duke çmontuar copë-copë pretendimet e ZPS-së. Avokati Luka Misetiq e ka nisur deklaratën përmbyllëse duke deklaruar se Thaçi është i pafajshëm dhe kjo është pikënisja prej ku duhet të merret vendimi nga trupi gjykues. Ai ka kërkuar lirim të Thaçit dhe kthimin e tij në Kosovë. “Kur t'i filloni kuvendimet tuaja, ju do të filloni nga qëndrimi se Hashim Thaçi është i pafajshëm dhe më pas ju do të vlerësoni nëse provat e paraqitura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ju kanë bindur juve, jashtë dyshimit të arsyeshëm, se Hashim Thaçi është fajtor”, u ka thënë Misetiq gjyqtarëve. Po ashtu, ai u ka thënë gjyqtarëve se shpallja fajtor e Thaçit do të përbënte padrejtësi ligjore dhe historike. “Argumentet e ZPS-së nuk përbëjnë interpretimin e

arsyeshëm vetëm të provave, që është standardi që duhet arritur që ju ta rishkruani historinë e Kosovës, në këtë rast për ta shpallur fajtor Hashim Thaçin. Ka dyshime të bazuara të mjaftueshme për ju që ta shpallni atë jofajtor për të gjitha pikat e aktakuzës”, ka thënë Misetiq. Në këtë kontekst, Misetiq ka përmendur disa nga deklaratat e dëshmitarëve në mbrojtje të Thaçit. “Ju keni dëgjuar nga dëshmitarët ndërkombëtarë që kanë thënë se Hashim Thaçi nuk dyshohej për krime lufte, ndërkohë që këto ngjarje po ndodhnin dhe po zhvilloheshin. Dëshmitarët ndërkombëtarë ju thanë se për këto ngjarje ishin të informuar përmes burimeve diplomatike, shërbimeve të inteligjencës dhe të tjera, si dhe përmes përvojave të tyre personale, përfshirë përvojat e tyre me Hashim Thaçin”, ka thënë Misetiq. Në mesin e figurave që dëshmuar në mbrojtje të Thaçit janë: ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s, Wesley Clark, ish-ndihmësi i sekretarit amerikan i Shtetit, James Rubin dhe diplomati i pensionuar amerikan, Christopher Hill. Më tutje, avokati i Thaçit i ka thënë trupit gjykues se e shih problematik faktin që në gjithë

dosjen e ZPS-së janë shpërfillur të gjitha provat të cilat diskreditojnë provat dhe pretendimet e saj. “Kur analizohen dhe shqyrtohen parashtrimet përfundimtare të ZPS-së është sikur të lexohet një kronikë apo analizë e një filmi të shkruar nga dikush që nuk e ka parë filmin”, ka thënë Misetiq. Duke folur për hierarkinë e UÇK-së, Misetiq ka deklaruar se Prokuroria e Hagës është frikësuar ta pyeste Bislim Zyrapi lidhur me rolin e Thaçit në operacionet ushtarake. “ZPS-ja nuk e kontestoi dëshminë e tij kur pati mundësinë t'i bënte pyetje shtesë. Zyrapi iu tha se në fillim të nëntorit 1998, Thaçi drejtonte Drejtorinë Politike, por nuk ka qenë i përfshirë në çështje ushtarake. E dimë se Zyrapi ka drejtuar operacionet nga tetori 1998. Zyrapi iu tha se Thaçi nuk ka pasur rol në operacionet ushtarake, e jo të ketë luajtur rol qendror. ZPS-ja tha se Zyrapi është dëshmitar i besueshëm. Nuk e kontestoi dëshminë e tij. Nuk duhet t'u vendosni peshë pretendimeve të ZPS-së se është besnik ndaj Thaçit. ZPS-ja nuk guxonte t'i bënte pyetjet sepse kishte frikë për përgjigjet që do të merrte. Nuk është e drejtë për dëshmitarin e as të akuzuarit”, ka thënë Misetiq.

thënë ai. Sa i përket pretendimit se UÇK-ja ka marrë hapa për të krijuar një qeveri të re, Misetiqi ka thënë: “Për këtë prokuroria citon deklaratën politike me numër shtatë. Por, është e qartë se ajo deklaratë politike trajton çështjen e krijimit të institucioneve të reja në kuadër të negociatave që do të mbaheshin me Serbinë dhe ndërmjetësoheshin nga ambasadori (Christopher) Hill. Deklarata nuk pretendonte se UÇK-ja po krijonte një qeveri të re në vetvete, dhe do ta përjashtonte LDK-në”, ka thënë Misetiq.

**ZPS-ja nuk ka prova se
Thaçi hartonte komu-
nikatat e UÇK-së**

Në sallën e gjyqit në Hagë, avokati i Thaçit, Luka Misetiq, ka kundërshtuar pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) lidhur me komunikatat e UÇK-së. Ai ka thënë se nuk ekzistojnë prova që Thaçi ka ushtruar funksionin e drejtorit të Drejtorisë Politike para periudhës së përmendur në aktakuzë. Më tutje, avokati i Thaçit ka thënë se prokuroria nuk ka sjellë prova që ai ka qenë figurë udhëheqëse në Lëvizjen Popullore të Kosovës, duke e cilësuar këtë si pretendim të pabazuar. Gjithashtu, ai ka theksuar se nuk ka dëshmi që Thaçi ka hartuar komunikata politike të UÇK-së. Sipas tij, ZPS-ja ka cituar vetëm dy prova për ta mbështetur këtë pretendim. “Nuk ka asnjë informacion që Thaçi të ketë mbikëqyrur shpërndarjen e informacioneve të UÇK-së. Se ka pasur përfshirje në përgatitjen e deklaratave politike, asnjë dëshmitar nuk ka dhënë dëshmi për këtë lidhur me faktin që Thaçi të ketë hartuar komunikata politike. Në fakt, ZPS-ja arrin të citojë vetëm dy prova për ta mbështetur pretendimin e tyre që Thaçi ka pasur rol në përgatitjen e tyre”, ka thënë Misetiq, duke shtuar se mbrojtja ka argumentuar se edhe Rexhep Selimi ka pranuar se nuk ka pasur njohuri se kush i përpilonte komunikatat, duke e cilësuar këtë si dëshmi që rrëzon pretendimet e prokurorisë ndaj Thaçit.

**Misetiq: Thaçi s’ka
pasur njohuri për krime
specifike të kryera nga
anëtarë të UÇK-së**

Avokati Luka Misetiq ka hedhur poshtë pretendimet e ZPS-së se Thaçi ka qenë në dijeni se ndonjë anëtar i qeverisë së përkohshme kishte kryer krime. “Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë caktuar bashkë me të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të qeverisë (së përkohshme). Prokuroria nuk ka arritur të provojë se Thaçi të ketë pasur njohuri që ndonjë anëtar i qeverisë së përkohshme të ketë kryer krime”, tha avokati. Sipas tij, prokuroria kishte argumentuar se KFOR-i nuk kishte marrë njoftime nga UÇK-ja se po

hetonte krimet e pretenduara nga anëtarët e saj. “Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë pasur njohuri për krime specifike të bëra nga anëtarët e UÇK-së që të ishin vartës të tij dhe për të cilët nuk ka pasur dijeni UNMIK-u dhe KFOR-i”, ka thënë Misetiq.

**Avokatja Tavakoli flet për
thirrjet e Thaçit për toler-
ancë në verën e vitit 1999**

Nina Tavakoli, avokate e Hashim Thaçit, në deklaratën përmbyllëse të ekipit të mbrojtjes në Gjykatën Speciale në Hagë, ka thënë se pretendimi i prokurorisë se qeveria e përkohshme e vendit dikur përdorej nga të akuzuarit si mjet për “një plan të përbashkët kriminal”, rrëzohet nga disa faktorë. Fillimisht ajo ka thënë se ekzekutivi përbëhej nga shumë parti dhe mbikëqyrej ndërkombëtarë. Ajo ka thënë se kjo qeveri “nuk ishte një mekanizëm pushteti”. “Krijimi i saj u mbështet nga ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe fuqi të tjera, si mënyrë për t’i unifikuar shqiptarët e Kosovës. Kjo mbështetje ndërkombëtare ngre dyshime se ajo u krijua si shtysë për të ekzekutuar një plan të përbashkët kriminal nga të akuzuarit për ta marrë nën kontroll Kosovën”, ka thënë Tavakoli. Në këtë kontekst, Tavakoli ka thënë se prokuroria s’ka “pikë prove” për t’i argumentuar pretendimet e veta. Sipas Tavakolit, pretendimi i prokurorisë do të qëndronte vetëm nëse ajo pretendon se ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe Evropa ishin në mbështetje të një plani të tillë kriminal. “A po thotë ZPS-ja që po bëhet fjalë për një dështim masiv të diplomatëve evropianë dhe shërbimeve të inteligjencës evropiane, të cilat nuk e kuptuan asnjëherë që ky ishte qëllimi i vërtetë. Si është e mundur që klienti ynë, që ishte vetëm 29 vjeç në atë kohë, t’i ketë gënjyer të gjithë ata?”, ka thënë avokatja.

Ajo ka thënë se Thaçi, në cilësinë e kryeministrit të asaj qeverie të përkohshme, nuk kishte pushtet real, duke shtuar se nuk mund të nënshkruante as marrëveshjen për çarmatosjen e UÇK-së, siç kishte dëshmuar ish-diplomati britanik John Stewart Duncan. Tavakoli ka pyetur prokurorinë se si Thaçi, sipas ZPS-së, synonte ta merrte nën kontroll Kosovën, kur ishte për çarmatosjen e UÇK-së, bashkëpunonte me UNMIK-un dhe i kishte pranuar humbjet në zgjedhjet e pasluftës deri në vitin 2007. “Si mundet që një person i tillë të duket një person që po mendohej të kishte dhe të fitonte kontroll mbi Kosovën? Ne themi që ky nuk është rasti”, ka thënë Tavakoli. Më tutje, Tavakoli ka folur kundër pretendimeve të ZPS-së se Thaçi ishte në dijeni dhe nuk kishte vepruar për të ndëshkuar apo parandaluar krimet e kryera në verën e vitit 1999. Tavakoli ka thënë se përgjegjës për ndjekjen e këtyre krimeve atëbotë ishte



UNMIK-u dhe Thaçi krejt çfarë mund të bënte, si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, ishte të fliste për to dhe ai ka folur. Tavakoli ka thënë se Thaçi ka bërë thirrje për tolerancë, ka kërkuar që serbët të mos largohen nga Kosova dhe kjo e ka ekspozuar, pretendoi ajo, ndaj rreziqeve personale dhe

politike. Ajo ka thënë se ZPS-ja është bazuar kryesisht në një dëshmitar ndërkombëtar që, sipas Tavakolit, ishte i ri në mision ndërkombëtar dhe nuk e kuptonte pse, pavarësisht prej deklaratave, dhuna nuk ndaloi. “Ne mendojmë se pse vazhdoi dhuna në verën e ’99-s pavarësisht prej thirrjeve për

tolerancë nga Thaçi, ishte pikërisht se Thaçi nuk e kishte pushtetin ndaj kryesve”, ka thënë Tavakoli. Procesi gjyqësor në Hagë do të vazhdojë edhe sot (e enjte). Deklaratat përmbyllëse do t’i paraqesë mbrojtja e Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

**Avokati amerikan i Thaçit tregohet i
pamëshirshëm me ZPS-në: Injorancë,
mungesë respekti. Si s’paskan pasur
informacion diplomatët dhe gjeneralët?**

Avokati amerikan i Hashim Thaçit, Pierre Prosper, gjatë deklaratës përmbyllëse ka goditur brutalisht prokurorët e ZPS-së. Kjo goditje ka ardhur pasi ZPS-ja i ka akuzuar diplomatët e njohur se nuk kishin informacione për UÇK-në. Prosper ka thënë e sjellja e prokurorisë ishte arrogante, injoruese dhe mungesë respekti. “Të nderuar zotërinj, duhet ta shikojmë ndryshe këtë çështje, sepse këto komente tregojnë arrogancë, mungesë respekti, i cili ka qenë i pranishëm qysh nga fillimi. T’i rrëzosh përvojat dëshmitë e këtyre profesionistëve, të cilët kanë pasur për detyrë t’i shikojnë, t’i analizojnë situatat, t’i shikojnë ngjarjet”, ka thënë Prosper, duke shtuar se kjo është arsyeja që qeveritë po humbin besimin në tribunalet ndërkombëtare. “Është e rëndësishme t’i kujtojmë vetes rëndësinë e dëshmitarëve, që mund të mos ju pëlqejnë, mund të mos respektoni dëshmitarët ndërkombëtarë, por duhet ta respektoni rolin që kanë pasur, profesionet e tyre, dhe shtetet që përfaqësojnë, Amerikën,

Britaninë, NATO-n”, ka thënë ai, duke shtuar se gjenerali Wesley Clark, James Rubin, Paul Williams, etj., kanë dhënë informacione të dorës së parë. Sipas tij, prokuroria është duke i cilësuar ata sikur kanë shkuar për turizëm në Kosovë. “James Rubin ka punuar për senatorin Biden, këshilltar i sekretares së Shtetit, ka pasur për detyrë për shkak se ka qenë në çdo takim me sekretaren. Ai ishte personi që u caktua të shkonte e të shihte kush ishte Hashim Thaçi. Ai pati mundësinë të bënte vëzhgime të veta. Paul Williams, profesor i nderuar. Këtu ishte një person i cili ka ndihmuar shtetet e dobëta të gjejnë paqe. Dhe këtë e ka bërë falas. Ka qenë i pranishëm atje, në sallë, ka dëgjuar bisedat me veshët e tij. Erdhi këtu vullnetarisht sikur të tjerët. Duncan, Durkee, diplomat karriere. Më shumë përvojë. Prapë prokuroria hodhi poshtë fjalët e tyre. Ambasadori Hill, gjashtë herë ambasadorë. Fakti që ai ka qenë i dërguar për Kosovën. Një detyrë ka pasur ai: të zbulojë çfarë roli kishte gjithsecili, çka ndodhte. Prokuroria do që ne të besojmë

se ai informacionin e ka të kufizuar, thjesht u detyrua të vinte këtu. Më vjen keq! E besueshme është kjo? Nëse Amerika, Britania, Franca, Italia, Gjermania, Rusia, këto shtete duhet të dinin kush ishte gjithsecili dhe çka bënte gjithsecili, e besoni që këta persona u kthyen dhe thanë informacione sipërfaqësore. Sikur do prokuroria që ne të besojmë. Po gjenerali Clark? Gjeneral me katër vje. Ka qenë në Dejton, gjenerali i forcave aleate-supreme në Evropë. Erdhi këtu dha pikëpamjet e tij, bazuar në informacionet që kishte marrë nga takimet profesionale dhe nga burimet e tjera. Ai ju ka thënë që lexoja çdo gjë. Nuk kishin shkuar për safari në Kosovë. Prokuroria beson se ata kanë qenë vetëm kalimtarë. Në këtë udhëtim bën disa konstatime sipërfaqësore. Dëshiron ta minimizojë rolin e tyre. Është mungesë respekti. Kjo tregon injorancë sa i takon këtij procesi. Këta diplomatë, ekspertë, bëhet fjalë për punën e jetës së tyre, erdhën vullnetarisht të flisnin me ju për të thënë këto dimë ne, këto kemi parë ne”, ka thënë Prosper.



KOSOVA DHE ÇLIRIMTARËT E SAJ: PROVIMI FINAL I PARIMEVE NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË

Kur aktakuzat selektive ngritin sfida historike dhe sprovë të integritetit global të ligjit



Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Proceset gjyqësore të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) përfaqësojnë jo thjesht një sfidë juridike, por një provë të jashtëzakonshme të drejtësisë ndërkombëtare dhe integritetit të saj global. Aktakuzat dhe interpretimet selektive të Prokurorisë rrezikojnë të politizojnë drejtësinë, të deformojnë historinë e luftës çlirimtare dhe të cenojnë besimin ndërkombëtar tek institucionet gjyqësore. Kjo analizë synon të nxjerrë në pah këto çështje duke u bazuar mbi parimet universale të së drejtës ndërkombëtare, precedentët juridikë globalë dhe kontekstin historik unik të Kosovës.

1. Lufta e Kosovës dhe e drejta për rezistencë

Lufta e Kosovës (1998- 1999) ishte rezistencë popullore kundër një regjimi shtypës dhe gjenocidal, i cili shkatërroi sistematikisht jetën civile, institucionet dhe kulturën shqiptare. Raporte ndërkombëtare nga OKB, UNMIK dhe Human Rights Watch dokumentojnë masakrat, dëbimet dhe shkatërrimin e fshatrave dhe qyteteve shqiptare. UÇK-ja veprimi si një forcë çlirimtare e njohur ndërkombëtarisht, duke mbrojtur popullsinë civile. Precedentët ndërkombëtarë e njohin këtë të drejtë: Tribunali i Nurembergut (1945): rezistenca kundër regjimeve agresive është e ligjshme. ICTY dhe ICTR: luftëtarët e lëvizjeve çlirimtare nuk trajtohen si agresorë, por veprimet e tyre vlerësohen brenda kontekstit të shtypjes dhe krimeve të palës kundërshtare. Legjitimiteti historik dhe ndërkombëtar i UÇK-së është i dokumentuar qartë; çdo interpretim që injoron këtë kontekst bie nën kategorinë e drejtësisë selektive.

2. Interpretimet selektive dhe rreziku i politizimit

Aktakuzat e Dhomave të Specializuara shpesh fokusohen tek veprime të izoluar të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, duke injoruar kontekstin e luftës dhe krimet sistematike të regjimit serb. Kjo sjell: Deformim historik - veprimet e UÇK-së nuk vlerësohen brenda genocidit, duke paraqitur një histori të pjesshme. Drejtësi selektive - masakrat e regjimit serb, si Reçaku (1999), nuk trajtohen proporcionalisht. Instrument politik - procesi gjyqësor perceptohet si mjet për rishkrimin e historisë. Ky fenomen ka precedentë në jurisprudencën ndërkombëtare, ku balanca mes drejtësisë dhe politikës është gjithmonë e brishtë, por vendimtare për legjitimitetin e vendimeve.

3. Krahase ndërkombëtare

Lëvizjet çlirimtare në shekullin XX dhe XXI kanë hasur sfida të ngjashme: ANC, Afrika e Jugut - pjesëtarët u ndoqën për veprime të armatosura kundër regjimit aparteid, por konteksti i shtypjes raciale i dha legjitimitet ndërkombëtar. Timor Lindor - luftëtarët e rezistencës u akuzuan nga autoritetet indoneziane, por tribunali ndërkombëtar dhe UNMISET njohën veprimin si mbrojtje kundër shtypjes. Ballkani (Kroaci, Bosnjë) - ICTY ka trajtuar luftëtarët që mbronin popullsinë si aktorë të ligjshëm në konflikt. Ky precedent tregon se veprimet e UÇK-së nuk mund të gjykojnë jashtë kontekstit të shtypjes dhe krimeve serbe; çdo interpretim selektiv bie nën kritikën e drejtësisë selektive.

4. Standardet ndërkombëtare

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (CEDNJ) dhe së drejtës humanitare ndërkombëtare: Çdo i akuzuar ka të drejtë për gjykim të drejtë dhe të barabartë. Trajtimi selektiv cenon parimet e barazisë dhe proporcionalitetit. Injorimi i kontekstit historik cenon legjitimitetin e procesit. Në Dhomat e Specializuara, fokusi ekskluziv mbi ish-pjesëtarët e UÇK-së, pa



ndjekur krimet e forcave serbe, përbën shkelje të frymës së drejtësisë ndërkombëtare.

5. Pasojat e procesit të politizuar

Proceset selektive sjellin pasoja të rënda: Tensione rajonale - narrativat e padrejta krijojnë përçarje ndërkombëtare. Dobësim i besimit ndërkombëtar - institucionet humbasin kredibilitet kur perceptohen si selektive. Rrezik për deformim historik - gjykimet pa kontekst mund të rishkruajnë historinë e luftës.

6. Konteksti i konfliktit dhe dokumentimi i krimeve serbe

Konflikti i Kosovës ishte luftë e armatosur e brendshme, ku forcat serbe kryen shkelje serioze të së drejtës humanitare: ekzekutime jashtëgjyqësore, shkatërrim të pronës civile, përdorim të tepruar force dhe dëbime masive. Raportet e Human Rights Watch dhe OKB-së tregojnë qartë se Serbia ishte palë agresive dhe gjenocidale, duke krijuar kontekstin për rezistencën e ligjshme të popullit shqiptar sipas së drejtës ndërkombëtare.

7. Gjendja juridike e Dhomave të Specializuara

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, të krijuara në vitin 2016, kanë mandat vetëm ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Krimet e forcave serbe nuk trajtohen në të njëjtin tribunal, duke krijuar imbalancë strukturore dhe duke ngritur dilema për legjitimitetin dhe proporcionalitetin.

8. Përgjegjësia individuale dhe konteksti i luftës

Në ligjin ndërkombëtar, përgjegjësia individuale vlerësohet brenda kontekstit të konfliktit, jo vetëm mbi veprime të izoluar. Dhomat e Specializuara duhet të zbatojnë këtë parim për të gjithë aktorët e konfliktit, duke ruajtur integritetin e drejtësisë ndërkombëtare.

9. Perceptimi publik dhe sfida e balancës së drejtësisë

Në Kosovë, opinionet shprehin shqetësim se gjykimi njëanshëm perceptohet si

rishkrim i historisë dhe nderit të UÇK-së. Kjo nuk është thjesht shqetësim emocional, por një çështje ligjore dhe historike, që lidhet me barazinë përpara ligjit dhe besimin në drejtësinë ndërkombëtare.

10. Parimet kyçe të drejtësisë ndërkombëtare

Për rivendosjen e besimit dhe legjitimitetit: Barazia përpara ligjit - trajtim i njëjtë për të gjitha palët në konflikt. Proporcionaliteti - ndjekje e krimeve në përputhje me shkallën e tyre të dokumentuar. Konteksti historik - analiza e veprimeve brenda shtypjes sistematike dhe konfliktit. Çlirimtarët e Kosovës në Hagë përfaqësojnë një provë për drejtësinë ndërkombëtare. Drejtësia duhet të jetë: E paanshme dhe e balancuar, e bazuar mbi precedentë ndërkombëtarë dhe dokumente të verifikuara, në respekt të parimeve universale të së drejtës humanitare. Çdo devijim nga këto parime rrezikon të dëmtojë jo vetëm individët, por edhe legjitimitetin global të drejtësisë ndërkombëtare dhe besimin e popujve tek institucionet ndërkombëtare.

Prokuroria në Pejë vazhdon intervistimet për dyshimet për manipulim të votave në Klinë

PEJË, 11 SHKURT - Prokuroria Themelore në Pejë ka njoftuar se do të vazhdojë intervistimi i personave përgjegjës për procesin e numërimit të votave në komunën e Klinës. Lidhur me dyshimet për

manipulim të votave, përkatësisht të rezultateve të kandidatëve të subjekteve politike në këtë komunë, Prokuroria Themelore në Pejë ka autorizuar hetimet rajonale të Policisë së Kosovës në Pejë

për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme hetimore, përfshirë intervistimin e personave në këtë proces. Prokuroria Themelore në Pejë mbetet e përkushtuar për zbardhjen e plotë të

rrethanave të këtij rasti dhe për garantimin e ligshmërisë dhe integritetit të procesit zgjedhor. Për zhvillimet e mëtejshme, opinioni publik do të njoftohet me kohë.



BIK-u DHE IPESHKVIA E KOSOVËS MBËSHTESIN MARSHIN “DREJTËSI, JO POLITIKË” MË 17 SHKURT

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Përfaqësuesit e platformës qytetare “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, janë pritur të mërkurën në takim nga kryetari i Bashkësia Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, për të diskutuar rreth marshit qytetar “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. Gjatë takimit kryemuftiu Tërnavë shprehu mbështetjen e plotë institucionale të BIK-ut dhe mbështetjen e tij personale për këtë marsh, duke e cilësuar atë obligim moral dhe patriotik. Ai theksoi se tashmë ka njoftuar të gjitha xhamitë e Kosovës që hytbeja e xhumasë, të premten më 13 shkurt, t'i

kushtohet 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës - me theks të veçantë në mesazhin përkrahës për luftëtarët e lirisë. “Mbështetja për drejtësinë dhe për ata që kontribuuan për lirinë e vendit është obligim moral dhe atdhetar. Drejtësia duhet të jetë e drejtë, e paanshme dhe në shërbim të së vërtetës”, u shpreh kryemuftiu Naim Tërnavë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tij personale në marsh. Nga ana e saj, përfaqësuesja e platformës, Eliza Hoxha, falënderoi kryemuftiun për mbështetjen dhe theksoi se përkrahja që po merr marshi nga bashkësitë fetare dëshmon karakterin qytetar dhe gjithëpërfshirës të kësaj iniciative. “Kur institucionet fetare, qytetarët dhe shoqëria bashkohen rreth parimeve të drejtësisë dhe dinjitetit, kjo



tregon se kauza jonë është mbi politikën ditore dhe në shërbim të vlerave themelore të shtetit”, tha Hoxha. Ndërkaq Ismail Tasholli theksoi rëndësinë e unitetit qytetar në momente kyçe për vendin. Përfaqësuesja e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha është pritur në takim edhe nga Ipeshkvi i Dioqezës Prizren - Prishtinë, e cila përfshin Kishën Katolike në Prishtinë, Imzot Dodë Gjergji, i cili i ka shprehur përkrahjen e komunitetit katolik për marshin “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. Në këtë takim Hoxha tha se mbështetja që po merr marshi edhe nga bashkësitë fetare është dëshmi se kjo kauzë

është mbi politikën ditore. “Ky marsh është një thirrje qytetare për respektimin e parimeve të drejtësisë, dinjitetit njerëzor dhe për ndarjen e qartë të drejtësisë nga politika”, tha Hoxha. Ndërkaq, Ipeshkvi Imzot Dodë Gjergji tha se drejtësia duhet të jetë e pavarur, e drejtë dhe në shërbim të së vërtetës. “Komuniteti katolik në Kosovë e mbështet këtë marsh si një angazhim qytetar për drejtësi të paanshme dhe për ruajtjen e vlerave themelore mbi të cilat është ndërtuar liria e vendit tonë”, shtoi ai. Platforma “Liria ka Emër” fton të gjithë qytetarët, organizatat dhe komunitetet që më 17 shkurt, në Ditën e Pavarësisë, t'i bashkohen marshit në Prishtinë për të dhënë një mesazh të qartë: Drejtësi, jo politikë.

Ushtrimi 36-orësh, kadetët e FSK-së përforcojnë aftësitë taktike

PRISHTINË, 11 SHKURT - Qendra për Studime Universitare (QSU) realizoi me sukses një ushtrim 36-orësh fushor gjatë të cilit kadetët zhvilluan trajnim praktik në operacione mbrojtëse.

Gjatë ushtrimit kadetët u angazhuan në një sërë detyrash operative, përfshirë fortifikimin e pozicioneve mbrojtëse, operacione zbulimi dhe mbrojtjen e zonës. Pjesë e këtij

ushtrimi ishin edhe tre kadetë nga Kolegji Mbretëror “Saint-Jean” i Kanadasë, të cilët po vijojnë studimet në QSU për një semestër. Ky aktivitet shërbeu për rritjen e

gatishmërisë profesionale dhe përmirësimin e aftësive taktike të kadetëve, duke dëshmuar përkushtimin e QSU-së për përgatitjen cilësore të kuadrove të ardhshme.



Rafuna dhe Berisha diskutojnë për mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional në mbështetje të bizneseve vendore

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim drejtorin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), Besnik Berisha, për të diskutuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në mbështetje të bizneseve vendore.

Gjatë takimit u theksua rëndësia e rritjes së qasjes në financa për ndërmarrjet, veçanërisht për NVM-të, përmes mekanizmave garantues që lehtësojnë kreditimin dhe nxisin investimet. Të dyja palët u pajtuan për forcimin e koordinimit dhe organizimin e aktiviteteve të

përbashkëta informuese për komunitetin e biznesit. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbeten të përkushtuara për krijimin e një mjedisi më të favorshëm financiar për zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e sektorit privat në vend.



KOSOVË - SHQIPËRI, FORCIM I PARTNERITETIT DOGANOR PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE ZHVILLIMIN EKONOMIK

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHKURT - Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, realizoi një takim zyrtar me drejtorin e përgjithshëm të Doganës Shqiptare, Besmir Beja, me synim thellimin e bashkëpunimit dypalësh dhe avancimin e agjendës së përbashkët në fushën doganore. Gjatë takimit u vlerësua përparimi i arritur ndër vite dhe niveli i lartë i koordinimit institucional, i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e procedurave, rritjen e efikasitetit operacional dhe zgjerimin e shkëmbimeve

tregtare ndërmjet dy vendeve. Vëmendje e veçantë iu kushtua funksionimit të Zyrës Doganore të Kosovës në Portin e Durrësit si dhe zbatimit të sistemit One Stop Shop në pikën kufitare Morinë. Këto mekanizma u vlerësuan si modele të suksesshme bashkëpunimi që kanë reduktuar kohën e pritjes, kanë ulur kostot për bizneset dhe kanë lehtësuar qarkullimin e mallrave dhe pasagjerëve. Drejtori Llugaliu theksoi rëndësinë strategjike të pranisë së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit, duke e cilësuar atë si një instrument kyç për fuqizimin e pozitës konkurruese të operatorëve ekonomikë të Kosovës dhe për

rritjen e qasjes në tregjet rajonale dhe më gjerë. Në kuadër të diskutimeve u trajtuan edhe prioritetet e përbashkëta për thellimin e digjitalizimit, avancimin e shkëmbimit elektronik të të dhënave dhe forcimin e bashkëpunimit në hetime të përbashkëta, me qëllim rritjen e transparencës, sigurisë dhe parandalimin e veprimtarive të paligjshme. Në përmbyllje, palët theksuan vullnetin për konsolidimin e mëtejshëm të partneritetit institucional dhe për ndërmarrjen e hapave të rinj që mbështesin lehtësimin e tregtisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë.



DELEGACIONI I FMN-së NJOFTOHET PËR PROJEKTET STRATEGJIKE ENERGJETIKE



PRISHTINË, 11 SHKURT - Ministria e Ekonomisë në detyrë, Artane Rizvanolli, ka pritur në takim delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili udhëhiqej nga shefi i Misionit për Kosovë, David Amaglobeli. Gjatë takimit palët diskutuan për zhvillimet aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me fokus të veçantë në sigurinë e furnizimit me energji elektrike, performancën e sektorit, si dhe sfidat dhe

perspektivat për periudhën e ardhshme. Delegacioni i FMN-së u njoftua për projektet strategjike energjetike që janë duke u zhvilluar, përfshirë investimet në burimet e ripërtëritshme të energjisë. Delegacioni i FMN-së vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet e Kosovës dhe shprehu gatishmërinë për ta vazhduar mbështetjen në fushat me rëndësi për stabilitetin ekonomik dhe

zhvillimin e vendit. Nga delegacioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar në takim morën pjesë: David Amaglobeli, shef i Misionit për Kosovë, Phakawa Jesakul, ekonomist i lartë nga Departamenti Evropian, Javier Kapsoli, ekonomist i lartë nga Departamenti Evropian, Ana Lariau, ekonomiste nga Departamenti Evropian dhe Selim Thaçi, ekonomist i lartë nga Zyra e Përfaqësuesit Rezident në Kosovë, Departamenti Evropian.

ZKA-ja auditon efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të pronave nga Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës


PRISHTINË, 11 SHKURT - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës "Efikasiteti dhe efektiviteti i administrimit të pronave nga Agjencia Kosovare për Krahassim dhe

Verifikim të Pronës (AKKVP)", për periudhën 2023-2025. Objektivi i këtij auditimi është të vlerësojë nëse Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës ka siguruar një sistem efektiv të qeverisjes, kontrollit të brendshëm dhe

llogaridhënies që garanton administrim efikas dhe transparent të pronave. Aktualisht AKKVP ka nën administrim mbi 11 000 prona në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë pronat banesore, komerciale dhe ato bujqësore.



KUNDËR TIRANISË SË SHUMICËS: PARALAJMËRIMI I JOHN STUART MILL VAZHDON TË JEHOJË EDHE SOT



Nga The Economist

Në moshën gjashtëvjeçare, John Stuart Mill kishte shkruar një histori të Romës. Në moshën shtatëvjeçare lexonte Platonin në greqisht. “Kjo duket si mburrje”, i shkruante i ati, James, një miku kur djali ishte tetë vjeç; “John tani zotëron gjashtë librat e parë të Euklidit dhe algjebërën.” Edukimi intensiv që nisi që në lindjen e tij më 1806 dha rezultatin e synuar: një fëmijë mrekulli me besim të thellë në fuqinë e arsyes. Ai u bë përfaqësuesi kryesor i filozofisë së liberalizmit, duke formuluar ide mbi ekonominë dhe demokracinë që formësuan debatet politike të shekullit XIX. Reflektimet e tij mbi të drejtat individuale dhe sundimin e turmës vazhdojnë të jenë aktuale. Sidomos sot. Mill u rrit në një epokë revolucionare. Demokracia po përhapej. Amerika ishte shkëputur nga Britania; Franca kishte përmbysur monarkinë. Në vitin 1832 Britania miratoi Aktin e parë të Reformës, duke zgjeruar të drejtën e votës për

klasën e mesme. Revolucioni Industrial ishte në kulm. Rendi i vjetër shoqëror, ku lindja përcaktonte pozicionin, po shpërbëhej. Askush nuk e dinte me siguri çfarë do ta zëvendësonte. Sot shumë e shohin Mill-in si simbol të kapitalizmit të ashpër të epokës së tij. Historiani amerikan Henry Adams e quajti “madhëria e tij satanike e tregtisë së lirë”. Në fotot e pakta që kanë mbetur, ai duket i ftohtë. Por nuk ishte i tillë. Në rininë e tij Mill ishte një utilitarist i bindur. Mentori i tij ishte Jeremy Bentham, i cili argumentonte se parimi themelor i çdo veprimtarie shoqërore duhet të ishte “lumturia më e madhe për numrin më të madh”. Qëllimi i ekonomisë ishte maksimizimi i dobisë. Fillimisht, Mill e shihte njeriun si një makinë llogaritëse. Por më vonë ai ndryshoi. Në autobiografinë e tij, botuar pas vdekjes më 1873, ai rrëfen se u rrit “në mungesë dashurie dhe në prani frike”. Në të njëzetat e hershme përjetoj një krizë nervore. Ai filloi të besonte se

jeta kishte më shumë se “llogaritja e kënaqësisë dhe dhimbjes” e utilitaristëve. Poezia e William Wordsworth dhe Samuel Taylor Coleridge i mësoi për bukurinë, nderin dhe besnikërinë. Ai arriti në përfundimin se disa kënaqësi janë më të larta se të tjerat. Ky përpunim i utilitarizmit tregonte pragmatizmin e tij. Ai shmangu absolutet dhe pranoi kompleksitetin e botës. Filozofi John Gray e përshkroi si një mendimtar “eklektik dhe tranzitor”, që nuk ofronte një doktrinë të vetme koherente. Mbi të gjitha, si çdo liberal, Mill besonte në fuqinë e mendimit individual. Në veprën “A System of Logic”, ai argumenton se dobësia më e madhe e njerëzimit është vetëmashtrimi për bindje të paekzaminuara. Ai kundërshtonte ortodoksitë dhe çdo gjë që pengonte mendimin e lirë. Në librin e tij më të famshëm, “On Liberty”, ai formuloi “parimin e dëmit”: pushteti mund të ushtrohet ndaj një individi kundër vullnetit të tij vetëm për të parandaluar dëmtimin e të tjerëve. Liria e

shprehjes ishte thelbësore për përparimin. Mill ishte një mbështetës i tregtisë së lirë, si për arsye ekonomike ashtu edhe filozofike. Kontakti me mendime dhe kultura të ndryshme, sipas tij, ishte thelbësor për zhvillimin njerëzor. “Nuk ka komb që të mos ketë nevojë të mësojë nga të tjerët”, shkruante ai. Ai mbështeti zgjerimin e të drejtës së votës dhe ishte ndër të parët që kërkoi votën për gratë, duke e konsideruar seksin të parëndësishëm për të drejtat politike. Megjithatë, ai paralajmëroi për rreziqet e kapitalizmit dhe demokracisë. Kapitalizmi mund të sillte dëme shpirtërore përmes “tiranisë së konformizmit”. Demokracia masive, nga ana tjetër, rrezikonte të shtypte mendimin individual nën peshën e shumicës. Ai e quajti këtë “tiraninë e shumicës”. Sipas Mill, opinioni publik mund të përjashtonte mendimtarët e lirë dhe të zhvlerësonte ekspertizën. Paradoksalisht, liria individuale mund të kufizohej

më shumë nën demokracinë masive sesa nën sundimtarë despotikë. Ai propozoi një rol të rëndësishëm për ekspertët dhe madje sugjeroi që votuesit më të arsimuar të kishin më shumë peshë në votë. Edhe pse sot kjo duket elitiste, për kohën e tij ai ishte përparimtar dhe do të kishte përkrahur shumë nga arritjet moderne, përfshirë votën universale dhe të drejtat e grave. Megjithatë, ai do të shqetësohej për zhvillimet e sotme. Anti-intelektualizmi, sulmet ndaj universiteteve dhe kufizimi i debatit do ta trondisnin. Në “On Liberty” ai shkruante se heshtja e një opinioni është një grabitje ndaj njerëzimit: nëse është i drejtë, na privon nga e vërteta; nëse është i gabuar, na privon nga përforcimi i së vërtetës përmes përplasjes me gabimin. Sot, me ringritjen e populizmit dhe sfidimin e liberalizmit klasik, idetë e Mill-it rikthehen në qendër. Ashtu si në kohën e tij, edhe sot kërkohet fleksibilitet intelektual dhe guxim për të mbrojtur lirinë kundër presionit të shumicës.



Zyrtare: Hamdi Namani huazohet te Gjilani

GJILAN, 11 SHKURT - Është mbyllur afati kalimtar i janarit në futbollin e Kosovës, teksa Gjilani ka bërë goditjen e fundit. Gjilani ka arritur ta regjistrojë mesfushorin llapjan Hamdi Namani. 31-

vjeçari i bashkohet Gjilanit si huazim deri në fund të sezonit nga Prishtina dhe ka qenë klubi kryeqytetas që ka konfirmuar një gjë të tillë. “Hamdi Namani huazohet te Gjilani deri në fund të sezonit. Në ditën e

fundit të afatit kalimtar, FC Prishtina dhe SC Gjilani kanë arritur marrëveshje për huazimin e mesfushorit Hamdi Namani deri në përfundim të këtij sezoni”. “Namani gjatë gjysmës së parë të kampionatit ka

regjistruar 21 paraqitje për Prishtinën në të gjitha garat, përfshirë edhe 4 ndeshje në kompeticionet evropiane. Ai kontribuoi me 3 gola dhe 1 asistim”, është në njoftimin e Prishtinës.



KOSOVA GATI PËR SHORTIN E LIGËS SË KOMBEVE

PRISHTINË, 11 SHKURT - Një herë në Ligën D dhe tri herë rresht në Ligën C, ndërsa tani Kosova për herë të parë do të garojë në Ligën B të Ligës së Kombeve në futboll. Liga e Kombeve është niveli i dytë i garës kontinentale për kombëtare, duke zëvendësuar kështu miqësoret dhe rritur të ardhurat financiare për federatat nacionale. Sezioni 2026/2027 i Ligës së Kombeve është i pesti i kësaj gare dhe dëshmon rritjen e Kosovës në futboll në vitet e fundit. Liga e Kombeve është e ndarë në katër nivele, përkatësisht liga, ku në Ligën A janë kombëtalet më të forta dhe në Ligën D janë katër më të dobëta. Shorti për sezonin e pestë të kësaj gare do të tërhiqet sot

(e enjte) në Bruksel nga ora 18:00, kurse Kosova është në vazon e katërt së bashku me Suedinë, Maqedoninë e Veriut dhe Irlandën e Veriut. Në vazon e parë të Ligës B janë Skocia, Hungaria, Polonia dhe Izraeli, në vazon e dytë janë Zvicra, Bosnjë-Hercegovina, Austria dhe Ukraina, kurse vazoja e tretë përbëhet nga Sllovenia, Gjeorgjia, Irlanda dhe Rumania. E pikërisht nga një kombëtare prej këtyre tri vazove, Kosova do ta ketë në grup hiç Bosnjë e Hercegovinën për shkak se nuk lejon UEFA. Ndeshjet e xhiros së parë të Ligës së Kombeve janë prej 24 deri më 26 shtator të këtij viti, xhiroja e dytë është prej 27 deri më 29 shtator, ndërsa e



treta prej 30 shtatorit deri më 3 tetor. Menjëherë prej datës 4 deri më 6 tetor është xhiroja e katërt, ndërsa dy xhirot e fundit të fazës grupore janë prej 12 deri më 14 nëntor dhe

prej 15 deri më 17 nëntor. Kosova ka kaluar në Ligën B duke e mposhtur para një viti Islandën në dy ndeshje të plejofit pasi doli e dyta në grupin e saj të Ligës C, i cili përbëhej nga Rumania,

Qipro e Lituania. Te Kosova aktualisht i gjithë fokusi është te ndeshja e 26 marsit ndaj Sllovakisë në Bratislavë, që është gjysmëfinalja e plejofit për kualifikim në Botërorin e këtij viti.

VALON BERISHA TRANSFEROHET TE ZURICHU



ZURICH, 11 SHKURT - Mesfushori i Kombëtares së Kosovës, Valon Berisha, do ta vazhdojë karrierën në Zvicër, saktësisht te skuadra e Zurichut. Berisha të mërkurën është paraqitur te Zurichu, ekip me të cilin ka firmosur kontratë deri në fund të sezonit me opsionin e vazhdimit edhe për një vit tjetër.

33-vjeçari së fundmi ishte te skuadra e LASK-ut në Austri, ndërsa për herë të parë në karrierë do të paraqitet në kampionatin e Zvicrës. Te klubi zviceran presin shumë nga Berisha, duke pasur parasysh përvojën e tij të madhe në futbollin evropian pasi ka luajtur edhe në Francë, Itali e Gjermani. Berisha ka edhe 52

paraqitje me Kosovën dhe 4 gola të shënuar, ndërsa ka qenë pjesë e skuadrave si Reims, Melbourne City, Lazio, Fortuna Dusseldorf, Salzburg dhe Viking. Berisha në prezantimin e tij ka thënë se është shumë i lumtur që do të jetë pjesë e Zurichut, ekip që me përvojën e tij dëshiron ta ndihmojë në arritjen e synimeve. Ai ka

insistuar se jo vetëm në stërvitje, por edhe në secilën ndeshje do të japë 100 për qind nga vetja në mënyrë që Zurichu t’u kthehet rezultateve pozitive. Aktualisht Zurichu renditet i dhjeti në tabelë me 25 pikë, ku në 23 ndeshje të zhvilluara në kampionat, ka regjistruar 7 fitore, 4 barazime dhe 12 humbje.

Tottenhami shkarkon trajnerin Thomas Frank

LONDËR, 11 SHKURT - Tottenham Hotspur ka marrë vendim ta shkarkojë trajnerin Thomas Frank pas rezultateve negative këtë edicion të Ligës Premier. Spurs është aktualisht në vendin e 14-t në Ligën Premier, vetëm pesë pikë mbi zonën e rënies nga kategoria, pasi nuk ka fituar asnjë nga tetë

ndeshjet e fundit në ligë dhe ka siguruar vetëm dy fitore në 17 ndeshjet e fundit. Ndeshja e fundit e Spursit në ligë ishte humbja 2-1 në shtëpi kundër Newcastle Unitedit dhe kjo ka bërë që drejtuesit e klubit të vendosin për shkarkimin e Frankut. “Klubi ka marrë vendimin për të bërë një

ndryshim në pozicionin e trajnerit kryesor të ekipit të meshkujve dhe Thomas Frank do të largohet sot. Thomas u emërua në qershor 2025 dhe ne kemi qenë të vendosur t’i japim atij kohën dhe mbështetjen e nevojshme për të ndërtuar së bashku të ardhmen. Megjithatë, rezultatet dhe

performancat e kanë çuar Bordin në përfundimin se një ndryshim në këtë pikë të sezonit është i nevojshëm”, ka njoftuar Tottenham Hotspur. Ndryshe, Franku është i ishte bashkuar Tottenhamit në qershor të vitit të kaluar në një kontratë trevjeçare, duke zëvendësuar Ange Postecoglou.





SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Zyrtar/e për Stabilitet Financiar
Niveli i gradës:	P06
Kohëzgjatja e punësimit:	Me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike dhe Hulumtimeve
Divizioni:	Divizioni i Stabilitetit Financiar
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Stabilitetit Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është në kërkim të një kandidati të kualifikuar dhe të motivuar për pozicionin e Zyrtarit për Stabilitet Financiar. Pozita ofron mundësi të shumta për zhvillim profesional në një mjedis dinamik dhe analitik, me përgjegjësi të rëndësishme në vlerësimin e rreziqeve sistematike, zhvillimin e politikave makroprudenciale dhe pjesëmarrjen në iniciativa kyçe që kontribuojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në vend. Kandidati i suksesshëm do të jetë pjesë e ekipit përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Stabilitetit Financiar dhe Mbikëqyrjes Makroprudenciale të institucioneve financiare.

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Analizon zhvillimet kryesore në ekonominë e Kosovës – me fokus në sistemin financiar, duke vlerësuar rreziqet sistematike përfshirë rreziqet makrofinanciare dhe tregun e pasurive të paluajtshme, rrezikun kreditor, të likuiditetit dhe të tregut - me qëllim identifikimin e faktorëve dhe trendëve që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e sistemit financiar;
- Vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit përmes kornizave monitoruese, aplikimit të stres-testimit dhe analizave të ndjeshmërisë, duke shqyrtuar ndikimin e goditjeve makroekonomike, financiare dhe të tregut në institucionet financiare dhe sistemin në tërësi;
- Përdor njohuritë mbi praktikatat e menaxhimit të rrezikut për të kontribuar në vlerësimin gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh cilësinë e aktiveve, likuiditetin, ekspozimet sektoriale, përqendrimet dhe faktorët makroekonomik;
- Monitoron tregues kyç për segmente të ndryshme të huamarrësve dhe industrive, si dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, për të identifikuar zona me rritje të mundshme të rrezikut;
- Përgatit raporte, analiza periodike dhe materiale teknike mbi zhvillimet e rreziqeve dhe ndikimin e tyre, duke mbështetur proceset analitike dhe vendimmarrjen në departament dhe Komitetin Këshillëdhënës për Makroprudencë;
- Bashkëpunon me njësite të brendshme dhe institucione financiare për sigurimin e të dhënave, harmonizimin e metodologjive dhe shkëmbimin e informacionit;
- Kryen detyra të tjera profesionale që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve, sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, matematikës, shkencave kompjuterike ose shkencën e të dhënave (data science) apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e njësive organizative; Preferohet diploma Master.
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar, ose përvojë pune në fushën që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar në këtë konkurs;
- Kërkohen aftësi të shquara analitike dhe interpretim/analizim të të dhënave;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Shkathhtësi të mira statistikore/ekonometrike dhe njohuri të programeve për përpunimin dhe analizim të të dhënave;
- Aftësi të caktimit të prioritetëve të punës dhe të përmbushjes së afateve;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon paku dy (2) vite përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 shkurt 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare
- të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh



RASPISAVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv:	Službenik/ca za finansijsku stabilnost
Rang:	P06
Trajanje zapošljavanja:	Na neodređeni period
Odeljenje:	Odeljenje za finansijsku stabilnost i ekonomske i istraživačke analize
Odsek:	Odsek za finansijsku stabilnost
Izveštava:	Šefu Odseka za finansijsku stabilnost

Centralna banka Republike Kosovo traži kvalifikovanog i motivisanog kandidata za poziciju Službenika za finansijsku stabilnost. Pozicija nudi brojne mogućnosti za profesionalni razvoj u dinamičnom i analitičkom okruženju, uz značajne odgovornosti u proceni sistemskih rizika, razvoju makroprudencijalnih politika i učešću u ključnim inicijativama koje doprinose sigurnosti i stabilnosti finansijskog sistema u zemlji. Uspešan kandidat biće deo tima odgovornog za pripremu Izveštaja o finansijskoj stabilnosti i za makroprudencijalni nadzor finansijskih institucija.

Rezime dužnosti i odgovornosti:

- Analizira ključna kretanja u ekonomiji Kosova, sa posebnim fokusom na finansijski sistem, procenjujući sistemske rizike, uključujući makrofinansijske rizike i tržište nepokretnosti, kreditni, likvidnosni i tržišni rizik, u cilju identifikovanja faktora i trendova koji mogu uticati na stabilnost finansijskog sistema.
- Ocenjuje otpornost sektora kroz primenu okvira za praćenje, stres-testiranja i analiza osetljivosti, razmatrajući uticaj makroekonomskih, finansijskih i tržišnih šokova na finansijske institucije i sistem u celini.
- Koristi znanja o praksama upravljanja rizikom kako bi doprineo sveobuhvatnoj proceni, uzimajući u obzir kvalitet aktive, likvidnost, sektorske izloženosti, koncentracije i makroekonomske faktore.
- Prati ključne pokazatelje za različite segmente zajmoprimaca i industrija, kao i razvoj na tržištu nekretnina, kako bi identifikovao zone sa potencijalnim povećanjem rizika.
- Priprema izveštaje, periodične analize i tehničke materijale o razvoju rizika i njihovom uticaju, podržavajući analitičke procese i donošenje odluka u odeljenju i Savetodavnom makroprudencijalnom odboru.
- Sarađuje sa internim jedinicama i finansijskim institucijama radi obezbeđivanja podataka, harmonizacije metodologija i razmene informacija.
- Obavlja i druge profesionalne zadatke povezane sa praćenjem i ocenom rizika, po zahtevu nadzornika.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, matematike, računarskih nauka ili nauke o podacima (data science) ili drugih srodnih oblasti koje se odnose na odgovornosti organizacione jedinice; Poželjna je master diploma.
- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja se odnosi na zadatke i odgovornosti navedene u ovom konkursu.
- Potrebne su izražene analitičke veštine i sposobnost interpretacije/analize podataka.
- Potrebno je demonstrirati izražene veštine verbalne i pismene komunikacije i prezentovanja nadzorniku i drugim stranama.
- Sposobnost efikasnog rada u timu; veštine upravljanja vremenom u vezi sa izvršenjem i kvalitetom radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa nadzornikom i timom; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja sa spoljnim stranama.
- Dobre statističke/ekonometrijske veštine i poznavanje programa za obradu i analizu podataka.
- Sposobnost određivanja prioriteta i poštovanja rokova.
- Odlično poznavanje engleskog jezika predstavlja prednost.

Svi kandidati trebaju dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Prijave sa nepotpuno ili netačno popunjenim službenim formularom CBK-a tokom online apliciranja neće biti razmatrane i rezultirat će diskvalifikacijom u procesu selekcije;
- Kandidati trebaju priložiti motivaciono pismo, adresirano i posebno pripremljeno za poziciju na koju apliciraju; u suprotnom, prijava neće biti uzeta u razmatranje;
- Dokaz o radnom iskustvu u trajanju od najmanje dve (2) godine (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji potvrđuju obavljanu poziciju i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih propisa o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trusta) za relevantni period koji pokriva najmanje dve (2) godine radnog iskustva, ili – u slučajevima kada se izveštaj iz Trusta zakonski ne primenjuje – poreska potvrda iz Poreske administracije Kosova (ATK);
- Kopije diploma; diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate / nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu / kopija lične karte koja služi kao potvrda državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **27 februar 2026**.
- Apliciranje se može izvršiti online putem stranice: <https://hris.bqk-kos.org> preko zvanične stranice CBK-a.
- Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Personel i Sigurisë Fizike (2 pozita)
Grada e pozitës: D13
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Divizioni: Siguria Fizike
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Fizike

Detyrat dhe përgjegjësitë:
BQK inkurajon të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për këto pozita pavarësisht gjinisë!
Më poshtë është bërë përmbledhja e përgjegjësiave dhe detyrave të vendit të punës “Personel i Sigurimit”:

- Të jetë vigjilent në mbrojtjen e pasurisë dhe personelit të BQK-s gjatë tërë kohës në detyrë;
- Të jetë i kujdesshëm dhe të ketë vetiniciativë në organizimin e pengimit të çfarëdo rreziku që mund t’i kanoset objektit dhe personelit të BQK-s;
- Të raportojë menjëherë për rastet të cilat paraqesin rrezik eventual ose tentimet e veprimeve të pa autorizuar të futjes në objekt etj. duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës;
- Të sigurojë që kushtet dhe rrethanat e sigurisë nuk rrezikojnë personelin e BQK-s, dhe duke respektuar rregullat intervenon në çdo situatë ku punëtori ose vizitori pëson ndonjë aksident, lëndim ose ndonjë humbje të gjësendeve të tyre;
- Të jetë në gjendje t’i kuptojë dhe t’i shfrytëzojë të gjitha pajisjet elektronike të sigurisë, si: sistemin e vëzhgimit me kamera, alarmet, etj. dhe të sigurojë të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë objektit;
- Të sigurojë që evidencat për çfarëdo rasti apo incidenti të mbesin të paprekura deri të arrijnë autoritetet për hulumtimin e tyre;
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për sigurinë – të raportojë menjëherë te udhëheqësi i DSF-së për çdo parregullsi të vërejtur;
- Ta kuptojë Politikën e Sigurisë Fizike të BQK-së, vendimet ekzekutive dhe urdhëresat administrative lidhur me sigurinë fizike, dhe t’iu përmbahet me përpikëri atyre;
- T’i përmbahet me përpikëri rregullores rreth punëve të përditshme të njësisë së sigurisë fizike;
- Të zbatojë të gjitha kërkesat lidhur me sigurinë të dhëna nga Udhëheqësi i Divizionit të Sigurimit dhe Bordi Ekzekutiv i BQK-s.

- Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**
- Shkollim i mesëm i lartë sipas legjislacionit në fuqi
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën e sigurisë fizike;
- Certifikimet nga organet e sigurisë apo mbrojtjes konsiderohen përparësi;
- Shkathtësi të mira komunikimi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë së paku tre (3) vite përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon së paku tre (3) vite përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 shkurt 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare
- të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh



OBJAVA ZA SLOBODNO RADNO MJESTO-(2 pozicije)

Naziv radnog mjesta: Službenik fizičke sigurnosti
Platni razred: D13
Trajanje zaposlenja: na neodređeno vrijeme
Divizija: Fizička sigurnost
Izvrštava: Rukovodiocu Divizije fizičke sigurnosti

Dužnosti i odgovornosti:
CBK podstiče sve zainteresovane da se prijave za ove položaje bez obzira na pol!
U nastavku je dat sažetak odgovornosti i dužnosti radnog mesta „Osoblje obezbeđenja”:

- Da bude oprezan u zaštiti imovine i osoblja CBK-a tokom čitavog vremena na dužnosti;
- Da bude pažljiv i preuzima inicijativu u organizovanju sprečavanja svakog rizika koji može ugroziti objekat i osoblje CBK-a;
- Da odmah prijavi slučajeve koji predstavljaju potencijalnu opasnost ili pokušaje neovlašćenih radnji za ulazak u objekat itd, sarađujući sa Policijom Kosova;
- Da obezbedi da bezbednosni uslovi i okolnosti ne ugrožavaju osoblje CBK-a, a uz poštovanje pravila interveniše u svakoj situaciji u kojoj radnik ili posetilac pretrpi nesreću, povredu ili bilo kakav gubitak svojih stvari;
- Da bude u stanju da razume i koristi sve elektronske bezbednosne uređaje, kao što su: sistem za nadzor kamerama, alarmi itd. i obezbediti sve prostore unutar i van objekta;
- Da obezbedi da dokazi za bilo koji slučaj ili incident ostanu netaknuti dok ne stignu organi za njihovu istragu;
- Da neprekidno proverava rad elektronskih uređaja koji služe za bezbednost - da odmah prijavi uočene nepravilnosti rukovodiocu OFO-a;
- Da razume Politiku za fizičko obezbeđenje CBK-a, izvršna rešenja i upravne naloge koji se odnose na fizičko obezbeđenje i da ih se strogo pridržava;
- Da se strogo pridržava propisa koji se odnose na svakodnevni rad jedinice za fizičko obezbeđenje;
- Da sprovodi sve zahteve koji se odnose na bezbednost date od strane rukovodioca Odseka za obezbeđenje i Izvršnog odbora CBK-a.

Kvalifikacije i potrebne radne iskustvo:

- Srednja stručna sprema, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Najmanje tri (3) godine radnog iskustva u oblasti fizičke sigurnosti;
- Certifikati izdati od sigurnosnih ili odbrambenih organa smatraju se prednošću;
- Dobre komunikacijske vještine.

Svi kandidati trebaju dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Prijave sa nepotpuno ili netačno popunjenim službenim formularom CBK-a tokom online apliciranja neće biti razmatrane i rezultirat će diskvalifikacijom u procesu selekcije;
- Kandidati trebaju priložiti motivaciono pismo, adresirano i posebno pripremljeno za poziciju na koju apliciraju; u suprotnom, prijava neće biti uzeta u razmatranje;
- Dokaz o radnom iskustvu u trajanju od najmanje tri (3) godine (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji potvrđuju obavljanu poziciju i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih propisa o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trusta) za relevantni period koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva, ili – u slučajevima kada se izveštaj iz Trusta zakonski ne primjenjuje – poreska potvrda iz Poreske administracije Kosova (ATK);
- Kopije diploma; diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate / nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu / kopija lične karte koja služi kao potvrda državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **27 februar 2026**.
- Apliciranje se može izvršiti online putem stranice: <https://hris.bqk-kos.org> preko zvanične stranice CBK-a.
- Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “High Quality Solution Information Technology” SH.P.K. me seli në Dragash Brezne, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811996000 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “High Quality Solution Information Technology” D.O.O. Dragash Brezne donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811996000 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “High Quality Solution Information Technology” L.L.C. with headquarters Dragash Brezne, has come to the decision to quit its business: 811996000 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arlinda Avdullahi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I, II, III të shkollës së mesme të lartë “Dr. Xheladin Deda”.

- Adelina Zhubi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2. 3. 4 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sadete Topalli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Migjeni” Baice Drenas.

- Nerxhivane Shabani shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjimnazit “Frang Bardhi”.

- Florian Gllareva shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dëshmoret e Fortesës” Verboc Drenas.

- Enis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.

- Denis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.

- Andi Reznici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjimnazit “Gjon Buzuku” Prizren.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershor deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

